L I G J
Nr.9598, datë 27.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8976, DATË 12.12.2002 "PËR AKCIZAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shtojca 1, bashkëlidhur ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5018, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

SHTOJCA 1

MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	P Përshkrimi	Shkalla Tatimore	
I	KAFE	ISHTE	BËHET
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	40 lekë/kg	50 lekë/kg
09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	80 lekë/kg	100 lekë/kg
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	40 lekë/kg	50 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg	250 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE		
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë ëmbëlsuese	2 lekë/litri	2 lekë/litri
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	2 lekë/litri	2 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE		
22 03	Birrë e bërë nga malto	30 lekë/litri	30 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara; shampanjë; musht rrushi	20 lekë/litri	20 lekë/litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese	20 lekë/litri	20 lekë/litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe	20 lekë/litri	20 lekë/litri

	pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër		
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% ose më tepër	200 lekë/litri	200 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denatyruar	0	0
22 08	Pije alkolike me forcë alkolike ndaj volumit mbi 12 për qind	130 lekë/litri	150 lekë/litri
	Pije alkolike me forcë alkolike ndaj volumit deri në 12 për qind	30 lekë litri	50 lekë litri
22 08 20 29	Raki	80 lekë/litri	100 lekë/litri
IV	Duhan dhe nënproduktet e tij		
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 240 lekë/kg	2 240 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	25 lekë/paketa	40 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg	1 500 lekë/kg
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS		
27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	35 lekë/litri	35 lekë/litri
27 10 11 51 27 10 11 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	46 lekë/litri	46 lekë/litri
27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 0	20 lekë/litri 0
27 10 19 31 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda (gazoil), si dhe vajra të rënda, si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	75 për qind, por jo më shumë se 33 lekë për litër dhe jo më pak se 13 lekë për litër	75 për qind, por jo më shumë se 33 lekë për litër dhe jo më pak se 13 lekë për litër
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg	40 lekë/kg
27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte i kalçimuar ose jo	1 lek/kg	1 lek/kg
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyror; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze)	5 lekë/kg	5 lekë/kg
29 01 29 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	5 lekë/kg	5 lekë/kg

VI	Artikuj kozmetikë, parfumeri dhe tualeti		
33 03 00 10	Parfume	60 për qind	60 për qind
33 03 00 90	Ujëra tualeti	60 për qind	60 për qind
33 07 20 00	Deodorante	60 për qind	60 për qind